EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6646
E hënë, 4 korrik 2022
çmimi 0.40

E ardhmja fatlume e Ballkanit është çmontimi e jo organizimi i tij

FAQE 4

Shkruan: Milazim KRASNIQI

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHTOHEN RASTET E TË INFEKTUARVE ME COVID NË KOSOVË

FAQE 4-5

Ditët e fundit në Kosovë janë shtuar rastet e të infektuarve me Covid-19. Në 24 orët e fundit janë regjistruar 164 raste të reja me Covid, ndërkaq numri i rasteve aktive ka kaluar mbi 1 000. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka paralajmëruar për rritje të rasteve edhe në ditët e ardhshme, duke bërë thirrje që qytetarët të jenë të kujdesshëm në zbatimin e masave. E ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka theksuar se tashmë jemi në stinën e pushimeve verore dhe vendi ynë pret që në ditët dhe javët në vijim, shumë mërgimtarë të vijnë në Kosovë, andaj mesazhi i tij është që qytetarët të vaksinohen

KRYEMINISTRI MERR PJESË NË FILLIMIN E KORRJE-SHIRJEVE TË GRURIT

FAQE 3

FESTIVALI "SUNNY HILL" DO TË MBAHET TE PARKU I GËRMISË

FAQE 5

AKTUALE

PENDAROVSKI PËR PROPOZIMIN FRANCEZ: AS TRIUMF HISTORIK, AS DËSHTIM F. 2

QEVERIA ENDE PA OFERTË PËR VETERANËT, PARALAJMËROHEN SËRISH PROTESTA F. 5

ARSIMI CILËSOR, NJË NGA SHTYLLAT KRYESORE PËR ZHVILLIMIN E KOSOVËS F. 4

ISH-PROKURORJA QË SINJALIZOI KORRUPSIONIN NË EULEX FITON RASTIN GJYQËSOR ME QEVERINË BRITANIKE F. 7

EKONOMI

KU MBETËN HEKURUDHAT MODERNE? F. 8

SPORT

SELIMI: RAST QË TË PARAQESIM VLERAT TONA PARA SHTETEVE MOSNJOHËSE F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Pendarovski për propozimin francez: As triumf historik, as dështim

Shkup, 3 korrik - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka deklaruar të dielën se propozimi i ri francez për zgjidhjen e kontestit me Bullgarinë është i pranueshëm pasi, sipas tij, bëhet fjalë për një "kompromis kalimtar", për të nisur bisedimet e anëtarësimit me Bashkimin Evropian.

Pas mbledhjes së Këshillit të Sigurisë Kombëtare, në të cilin marrin pjesë institucionet kryesore të shtetit, presidenti Pendarovski tha sa qeveria duhet të miratojë edhe një konkluzion apo aneks në propozimin e modifikuar se do t'i refuzojë bisedimet në rast se gjatë këtij procesi pala bullgare insiston që të negociohet edhe për gjuhën dhe identitetin maqedonas. "Ne nuk duhet të presim që dikush të na bllokojë, por ne duhet menjëherë të tërhiqemi nga bisedimet. Këtë e them sepse e dimë se me kë kemi punë", ka deklaruar presidenti Pendarovski.

Kreu i shtetit tha se beson se me propozimin e modifikuar francez nuk rrezikohen çështjet që kanë të bëjnë me identitetin maqedonas dhe se nuk mund të bëhet fjalë për bullgarizimin e maqedonasve, siç pretendon opozita dhe personalitete të tjera politike dhe akademike në Maqedoninë e Veriut. "Frika te një pjesë e maqedonasve se në BE do të hyjmë vetëm si bullgarë nuk qëndron. Si mundet që një maqedonas të bëhet bullgar?... Në historinë e diplomacisë botërore nuk ekziston diçka e tillë, se me marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe dikush brenda natës jua ndërron identitetin", ka deklaruar Pendarovski.

Ai shtoi se vendimi për ta pranuar propozimin e modifikuar francez "nuk është as triumf historik apo dështim dhe mossukses". "Konsideroj se bëhet fjalë për një kompromis kalimtar për njërën nga fazat e integrimit evropian, që ka tri elemente të rëndësishme dhe për mua në këtë fazë është i pranueshëm", tha Pendarovski.

Ndërkohë lidhur me propozimin francez, kryeministri Dimitar Kovaçevski të dielën ka takuar edhe liderin e opozitës

maqedonase, Hristijan Mickoski, në kuadër të konsultimeve me partitë politike dhe faktorët e tjerë në vend.

Kryeministri Kovaçevski ka vlerësuar se propozimi i modifikuar francez "nuk rrezikon as gjuhën e as identitetin maqedonas dhe është mundësia e vetme për zhbllokimin e procesit të integrimit evropian" , ndërkohë që kryetari i VMRO DPMNE-së mbetet në qëndrimin se "propozimi i ri nuk dallon nga i pari në përmbajtje, e cila është e dëmshme për interesat kombëtare dhe shtetërore maqedonase".

Rusia pretendon se ka në kontroll një qytet kyç të Ukrainës

Kiev, 3 korrik - Rusia pretendoi të dielën se ka pushtuar qytetin strategjik ukrainas të Lisiçansk dhe të gjithë rajonin e vijës së parë të Luhanskut i cili do të shënonte një përparim vendimtar për forcat e Moskës që kërkonin kontrollin e lindjes së vendit.

Zhvillimi erdhi pasi Bjellorusia tha se kishte kapur raketa të lëshuara nga Kievi dhe Rusia raportoi se Ukraina lëshoi tri raketa në Belgorod,

duke vrarë katër persona.

Lisiçansk kishte qenë qyteti i fundit i madh në zonën e Luhanskut të Donbasit lindor ende në duart e Ukrainës dhe kapja e tij do të sinjalizonte një shtytje më të thellë në Donbas, fokusi i Moskës që nga tërheqja nga Kievi.

Të shtunën pati raporte kontradiktore në lidhje me statusin e Lisiçanskut kur Ukraina mohoi pretendimin e Moskës se kishte rrethuar të gjithë qytetin, i vendosur përtej lumit nga fqinji Severodonjeck, të cilin forcat ruse e kapën javën e kaluar.

Ukraina nuk ka komentuar ende mbi pretendimin se Lisiçans ka rënë pas luftimeve intensive. "Sergei Shoigu ka informuar komandantin e përgjithshëm të forcave të armatosura ruse, Vladimir Putin, për çlirimin e Republikës Popullore të Luhanskut", tha ministria e Mbrojtjes në një deklaratë të cituar nga agjencitë ruse të lajmeve.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt nga një sulm i Rusisë dhe deri më tani ka lënë mijëra të vrarë dhe miliona refugjatë.

Gjermanëve u kërkohet të përgatiten për mungesë të gazit

Berlin, 3 korrik - Nga frika se Rusia mund t'i ndërpresë furnizimet me gaz natyror, kreu i Agjencisë Rregullatore të Energjisë së Gjermanisë u ka bërë thirrje banorëve të shtunën ta kursejnë energjinë dhe të përgatiten për dimër, kur përdorimi i energjisë elektrike rritet.

Presidenti i Agjencisë Federale të Rrjetit, Klaus Mueller, u ka bërë thirrje pronarëve të shtëpive dhe apartamenteve që t'i kontrollojnë dhe rregullojnë kaldajat dhe radiatorët e tyre të gazit për ta zvogëluar efikasitetin e tyre. "Mirëmbajtja mund ta zvogëlojë konsumin e gazit nga 10 % deri në 15 %", tha ai për mediet gjermane.

Mueller tha se banorët dhe pronarët e pronave duhet të përdorin 12 javët përpara se të fillojë moti i ftohtë për t'u përgatitur. Ai tha se familjet duhet të fillojnë të flasin tani "nëse çdo dhomë duhet të vendoset në temperaturën e saj të zakonshme në dimër - ose disa dhoma mund të jenë pak më të ftohta".

Apeli erdhi pasi Rusia reduktoi flukset e gazit në Gjermani, Itali, Austri, Republikën Çeke dhe Sllovaki në fillim të këtij muaji.

Kompania shtetërore ruse e energjisë "Gazprom" fajësoi një problem teknik për shkurtimin e gazit natyror që rrjedh përmes Rrjedha Veriore 1, një tubacion që kalon nën Detin Baltik nga Rusia në Gjermani.

Kompania ka thënë se pajisjet që po rinovoheshin në Kanada kishin ngecur atje për shkak të sanksioneve perëndimore mbi luftën e Rusisë në Ukrainë.

Udhëheqësit gjermanë e kanë hedhur poshtë këtë shpjegim dhe i kanë quajtur reduktimet një veprim politik si reagim ndaj sanksioneve të Bashkimit Evropian kundër Rusisë pasi ajo pushtoi Ukrainën.

Zëvendëskancelari Robert Habeck, i cili është gjithashtu ministër i Ekonomisë dhe Klimës së Gjermanisë dhe përgjegjës për energjinë, ka paralajmëruar se një "bllokim" i gazsjellësit është i mundur duke filluar nga 11 korriku, kur do të fillojë puna e rregullt e mirëmbajtjes. Në verërat e mëparshme puna ka sjellë mbylljen e Rrjedhës Veriore 1 për rreth 10 ditë, tha ai.

Pyetja është nëse mirëmbajtja e ardhshme e rregullt e

gazsjellësit Rrjedha Veriore 1 do të kthehet në "një mirëmbajtje politike më afatgjatë", tha Mueller i rregullatorit të energjisë.

Nëse fluksi i gazit nga Rusia "do të ulet për një periudhë më të gjatë kohore, do të duhet të flasim më seriozisht për kursimet", tha ai. Sipas Muellerit, në rast të ndërprerjes së furnizimit me gaz, ekonomitë familjare do të mbroheshin posaçërisht, ashtu si spitalet apo shtëpitë e pleqve. "Unë mund të premtoj se do të bëjmë gjithçka që mundemi për të shmangur që ekonomitë familjare të jenë pa gaz", tha ai, duke shtuar: "Ne mësuam nga kriza e koronavirusit se nuk duhet të bëjmë premtime nëse nuk jemi plotësisht të sigurt se mund t'i mbajmë ato".

Ai tha se agjencia e tij "nuk sheh një skenar në të cilin nuk ka më gaz fare që vjen në Gjermani".

Në fillim të këtij muaji ministri i Ekonomisë, Habeck, aktivizoi fazën e dytë të planit të urgjencës me tri faza të Gjermanisë për furnizimet me gaz natyror, duke paralajmëruar se ekonomia më e madhe e Evropës u përball me një "krizë" dhe objektivat e magazinimit për dimër ishin në rrezik.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryeministri merr pjesë në fillimin e korrje-shirjeve të grurit

Albulena S. MAVRAJ

SUHAREKË, 3 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar të dielën fshatin Sopijë të komunës së Suharekës, në të cilin kanë filluar korrje-shirjet e grurit.

Së bashku me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, kryeministri ka vizituar fermerin Fazli Beqiraj i cili ka rreth 60 hektarë grurë.

"Këtë vit presim rendiment më të lartë për shkak të kushteve të volitshme klimatike që kanë mbizotëruar në vendin tonë", ka thënë Kurti.

U theksua se falë mbështetjes së Qeverisë së Kosovës, bujqit në Kosovë janë më të përkrahurit krahasuar me vendet e rajonit.

Një hektar me grurë këtë vit subvencionohet rreth 474 euro, duke përfshirë për herë të parë subvencionimin e vlerës së akcizës së naftës prej 0.36 centësh si dhe plehërimin pranveror me 150 euro për hektar. Po ashtu, bujqit kanë mundësinë e subvencionimit për rendiment të grurit me 0.03 cent për kilogram përmes dorëzimit në mullinj. Kultura e grurit ka një rritje prej 216 % të mbështetjes financiare krahasuar me qeverisjet e kaluara. Qeveria e Republikës së Kosovës i ka dhënë prioritet bujqësisë duke rritur përkrahjen deri në 52 milionë euro për Programin e Pagesave Direkte, Subvencioneve 2022", u tha gjatë kësaj vizite.

Festivali "Sunny Hill" do të mbahet te Parku i Gërmisë

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Festivali i muzikës "Sunny Hill" pritet të mbahet në fillim të muajit gusht në Parkun e Gërmisë në Prishtinë. Për lokacionin e festivalit që deri më tani nuk dihej, ka njoftuar të shtunën kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama. Ai ka thënë se janë siguruar lejet e nevojshme për mbajtjen e festivalit në këtë park më 4, 5, 6 dhe 7 gusht 2022. "Për shkak të kufizimeve të hapësirës në parkun e Gërmisë, 'Sunny Hill Festival' këtë vit do të ketë kapacitet të kufizuar të pjesëmarrësve, përkundër potencialit dhe nevojave në rritje që i ka festivali", ka shkruar Rama në "Facebook".

Ai ka shtuar se "Sunny Hill Festival" është zotuar se e gjithë hapësira e parkut që do të merret në shfrytëzim do të përdoret me kujdes të shtuar, dhe se pastrimi dhe rigjenerimi i parkut "do të bëhet në afat rekord, edhe me investimet e nevojshme nga ana e 'Sunny Hill Festival'".

Informacioni mbi lokacionin e festivalit vjen disa ditë pasi u bë e ditur se festivali do të mbahet përfundimisht në Prishtinë, pas një vendimi fillestar që festivali të largohej nga Kosova.

Më 14 qershor themeluesi dhe organizatori i këtij festivali, Dukagjin Lipa, pati bërë me dije që "Sunny Hill" do të zhvendoset në Tiranë "për shkak të vonesave të shumta të shkaktuara nga mungesa e përgjigjes dhe vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të hapësirës për festivalin".

Palët kanë qenë në diskutim të dhënies në shfrytëzim të një parcele prej 17 hektarësh për 99 vjet në fshatin Bërnicë e Poshtme.

Mirëpo sipas deklaratës së 20 qershorit, palët kanë shprehur gatishmëri "që çështja e shfrytëzimit afatgjatë të tokës të diskutohet edhe pak kohë deri në gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme".

Aty, po ashtu, është bërë me dije që një edicion i veçantë me këngëtarë të tjerë do të mbahet në Tiranë më 26, 27 dhe 28 gusht.



Festivali është themeluar nga "Fondacioni Sunny Hill", i këngëtares me famë botërore Dua Lipa dhe edicioni i parë është mbajtur më 2018.

Edicioni i vitit 2020 ishte anuluar për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Plagosja e dy policëve në Skenderaj, lirohet Nuredin Lushtaku



SKENDERAJ, 3 KORRIK - Dy pjesëtarë të Policisë së Kosovës kanë mbetur të plagosur nga një përleshje që ka ndodhur të shtunën në mbrëmje në Skenderaj, ku dyshohet se i përfshirë ka qenë ish-nënkryetari i komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku.

Ky i fundit është liruar nga ndalimi policor pas intervistimit nga policia.

Lajmin për lirimin e tij e ka bërë me dije t për "Telegraf"-in, avokati Artan Qerkini. "Po, është liruar nga ndalimi policor. Nuk ekziston dyshimi që ai ka përdorur armë në rastin në fjalë. Policia do t'i zhvillojë hetimet. Ne jemi të interesuar që hetimet të zhvillohen të plota në mënyrë që të zbardhet e gjithë e vërteta e këtij rasti, pa zhvillime të hetimeve natyrisht ne do t'i përdorim të gjitha ato mjete juridike që i kemi në dispozicion varësisht prej rezultatit të procedurës së hetimeve", ka thënë ai.

Dy policë janë plagosur në Skenderaj të shtunën pas mesnatës. Siç bëhet me dije nga policia, ata janë plagosur në një pikë kontrolli. "Me datë 02.07.2022, rreth orës 23:55, është raportuar se në Skenderaj, gjatë një pikë të kontrollit, janë sulmuar dy zyrtarë policorë, njëri është i plagosur me armë zjarri në këmbë, tjetri është i lënduar nga mjetet e forta", thuhet në njoftim.

Policia ka njoftuar se të dy zyrtarët policorë janë jashtë rrezikut për jetë. Ata janë dërguar në QKUK për trajtim mjekësor. Për këtë incident ka pasur reagime të shumta nga politikanë dhe shoqëria civile, të cilët kanë dalë në mbrojtje të policisë.

© Reuters/L. Hasani

Shtohen rastet e të infektuarve me Covid në Kosovë

Ditët e fundit në Kosovë janë shtuar rastet e të infektuarve me Covid-19. Në 24 orët e fundit janë regjistruar 164 raste të reja me Covid, ndërkaq numri i rasteve aktive ka kaluar mbi 1 000. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka paralajmëruar për rritje të rasteve edhe në ditët e ardhshme, duke bërë thirrje që qytetarët të jenë të kujdesshëm në zbatimin e masave. E ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka theksuar se tashmë jemi në stinën e pushimeve verore dhe vendi ynë pret që në ditët dhe javët në vijim, shumë mërgimtarë të vijnë në Kosovë, andaj mesazhi i tij është që qytetarët të vaksinohen

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 3 korrik - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të dielën se pas 570 testimeve, 164 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shëruar 49 qytetarë, ndërsa në total numri i rasteve aktive është 1 012.

Në 24 orët e fundit janë vaksinuar 14 persona.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 830 700 doza të vaksinës. Deri më sot 823 767 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka theksuar se Kosova shënon këtyre ditëve shtim të rasteve të reja me Covid-19 me tendencë të rritjes në ditët në vijim. "Në vende të ndryshme të botës po regjistrohen raste të shumta të Covid-19, sepse pandemia Covid-19 nuk ka mbaruar. IKShPK është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje e shijes, rekomandohen të testohen", ka njoftuar ky institut.

IKShPK-ja ka theksuar se me qëllim të përforcimit të imunitetit dhe parandalimit të rasteve të reja dhe formave të rënda të sëmundjes, qytetarët këshillohen të vaksinohen, me dozën e parë ata që ende s'janë vaksinuar, kurse të tjerët me dozën e dytë dhe dozën e tretë të vaksinës kundër Covid-19. "MSh dhe IKShPK u rekomandojnë qytetarëve që, përkundër situatës së qetë dhe stabile epidemiologjike në vend, të jenë të kujdesshëm në zbatimin e masave preventive kundër sëmundjeve ngjitëse dhe të vaksininohen kundër Covid-19", ka njoftuar IKShPK-ja.

Ndërkaq ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka thënë se Kosova është vendi me shkallën më të lartë të vaksinimit kundër Covid-19 në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sipas tij, ekipet tona të vaksinimit kanë dhënë deri tash mbi 1.8 milion doza të vaksinës, ndërsa rreth 1 milion qytetarë kanë marrë së paku një dozë të vaksinës. "Ajo që kemi parë ditët e fundit, ku rastet e Covid-19 janë rritur, na dëshmon të gjithëve se pandemia nuk ka përfunduar dhe ne kemi ende rrugë për të bërë deri në fundin e saj", ka thënë ministri Latifi. Ai ka thënë se variantet e reja dhe zbehja e kujdesit ndaj virusit përbëjnë një rrezik real për ne dhe familjet tona. "Sidomos për ata që nuk janë vaksinuar ende. Kjo mund të sjellë vështirësi të tjera për personelin shëndetësor dhe t'i kthejë pamjet dhe përjetimet e rënda në spitalet tona", është shprehur ai.

Ministri ka bërë thirrje për ta rritur kujdesin ndaj këtij virusi. "Për ta evituar kthimin e kufizimeve të rënda, të cilat nuk i do askush nga ne, por që në situata të caktuara imponohen. Jemi në stinën e pushimeve verore dhe vendi ynë pret që në ditët dhe javët në vijim shumë mërgimtarë të vijnë në Kosovë për t'u bashkuar me familjet e tyre dhe për të ndarë momente gëzimi dhe përjetime të ndryshme me të gjithë ne. Ata do të vijnë në shtëpitë, familjet dhe në vendin e tyre të dashur dhe ne, si gjithmonë, i mirëpresim. Ju lusim që t'i shfrytëzoni mundësitë e ofruara në vendet prej nga vini dhe të vaksinoheni. Nëse s'e keni bërë këtë, do t'ju ofrojmë çdo mundësi që vaksinën ta merrni në Kosovë, për të pasur pushime të rehatshme e të shëndetshme", ka qenë thirrja e ministrit Latifi.

Ai ka theksuar se Kosova, falë angazhimit të institucioneve të saj dhe përkrahjes së miqve, ka vaksina të mjaftueshme për çdo qytetar që është apo që mund të vijë këtu. "Për të gjitha moshat dhe kategoritë e popullatës. Por, kemi nevojë që thirrjes për vaksinim t'i përgjigjeni me përgjegjësi", ka thënë Latifi.

Sekretariati i EU digital Certificate i Komisionit Evropian e ka njoftuar Ministrinë e Shëndetësisë se është konfirmuar pranueshmëria - vendimi mbi ekuivalencën e certifikatës digjitale të vaksinës kundër Covid-19, e lëshuar nga Kosova në EU digital certificate, me qëllim lehtësimin e së drejtës së lëvizjes së lirë brenda shteteve të Bashkimit Evropian.

Qeveria ende pa ofertë për veteranët, paralajmërohen sërish protesta

PRISHTINË, 3 KORRIK - Janë bërë më shumë se dy javë që kur kryeministri Albin Kurti u ka premtuar shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së se do t'i dërgojë një propozim-ofertë në formë të shkruar lidhur me kërkesat e tyre për pensione. Megjithatë, qeveria ende nuk ka dërguar një ofertë të tillë te veteranët.

Lidhur me këtë, zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu, thotë për "KosovaPress" se ekzekutivi ka finalizuar një propozim konkret dhe përmbajtjesor dhe brenda një kohë shumë të shkurtër do ta ndajnë me përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së. "Në takimin me përfaqësuesit e organizatave të veteranëve të luftës që kryeministri Kurti ka mbajtur në zyrën e tij është ritheksuar përkushtimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për thellimin e bashkëpunimit me Organizatën e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së veteranëve të UÇK-së. Në takim janë prezantuar edhe propozimet e qeverisë në këtë drejtim, të cilat propozime u dorëzohen përfaqësuesve të këtyre organizatave edhe në formë të shkuar. Ne kemi finalizuar një propozim konkret dhe përmbajtjesor dhe brenda një kohë shumë të shkurtër do ta ndajmë me përfaqësuesit e organizatave të veteranëve të luftës", thotë Kryeziu.

Nënkryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Muhamet Bilalli, thotë se deri të premten nuk kanë pranuar asnjë propozim me shkrim nga qeveria. Billalli thotë se nëse nuk përmbushen kërkesat e tyre, këto shoqata do të organizojnë sërish protesta në ditën kur do të shqyrtohet në lexim të dytë Projektligji për Pagën Minimale. "Deri sot qeveria nuk ka kthyer asnjë përgjigje, edhe pse kryeministri ka premtuar që do ta bëjë me shkrim një ofertë. Po presim. Jemi mësuar me këtë qeveri që premton dhe nuk realizon. Për veprimet e shoqatave të dala nga lufta do të vendosin kryesitë, këshilli drejtues, mirëpo qëndrimet e shoqatës dhe të ushtruesit të detyrës së shoqatës së veteranëve të luftës, Faton Klinaku, Xhavit Jashari, Fadil Shurdhaj, edhe të kryesisë, janë që në atë moment që shkon në lexim të dytë Projektligji për Pagën Minimale, pra veteranët prapë do të dalin në protesta. Deri në ditën e fundit nuk do të ndalemi për t'i kërkuar të drejtat tona, që janë të drejta minimale", thotë ai.

Bilalli thotë se kërkesat e tyre janë legjitime dhe nuk do të lëshojnë "pe" në asnjë mënyrë për realizimin e tyre. "Asnjëherë nuk do të largohemi nga kërkesat tona, që janë kërkesa minimale. Është turp për qeverinë të bëjë kaq shumë zhurmë për asgjë hiç. Mirëpo jemi mësuar me këtë qeveri, me deklaratat e saj. Qeveria e ka gabim. Ka hyrë në një rrugë pa krye. Organizatat e dala nga lufta nuk do të lëshojnë pe deri në pikën e fundit për kërkesat e tyre. Kërkesat janë legjitime", thotë ai.

Ndërkaq kryeministri Albin Kurti në konferencën për medie mbajtur më 18 qershor, një ditë pas takimit me drejtues të shoqatave të dala nga lufta, ka thënë se gjatë javës së ardhshme do t'ua dorëzojnë organizatave të dala nga lufta propozimin e tyre si zgjidhje për kërkesat e tyre. "Propozimet me shkrim do t'i dërgohen sa më shpejt që të mundemi, gjatë javës së ardhshme patjetër, dhe bashkë me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve jemi duke punuar në një propozim konkret, ofertë përmbajtjesore me shkrim, të qartë për organizatat e dala nga lufta. Jam i hapur për dialog, për komunikim, për kontakte të rregullta. Zyrën time e kanë të hapur për të gjitha takimet dhe dilemat që mund t'i kenë, por në të njëjtën kohë e shpreh edhe përkushtimin tim, jo vetëm me këtë çështje, se Qeveria e Kosovës është e interesuar që UÇK-ja të trajtohet me dinjitet edhe sa i përket zhvillimit socio-ekonomik të vendit tonë, por edhe sa i përket aspektit institucional e demokratik të shtetit të pavarur të Kosovës. Pra, nuk duam rritje ekonomike e mirëqenie pa veteranët, dhe nuk duam demokraci e pavarësi pa veteranët. I duam me ta", ka thënë Kurti.

Takimi i drejtuesve të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në qeveri me kryeministrin Albin Kurti kishte ardhur një ditë pas protestës së veteranëve të organizuar para Kuvendit të Kosovës, ndonëse pas takimit veteranët kanë theksuar se nuk ishin pajtuar me asnjë nga pikat e shefit të ekzekutivit.

Arsimi cilësor, një nga shtyllat kryesore për zhvillimin Kosovës

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - "Arsimi cilësor është një nga shtyllat kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të Kosovës", tha kryeministri Albin Kurti në hapje të Olimpiadës së Tretë Matematike Kosovë-Shqipëri për Klasat VII-IX. "Ne duhet të synojmë të frymëzojmë qysh herët te nxënësit ndërveprimin me konceptet e shkencës, duke nxitur garë ndërmjet ekipeve dhe shkollave. Olimpiada që mbahet sot e jep një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim", tha kryeministri, duke shtuar se kjo olimpiadë i kontribuon ndërtimit të urave të bashkëpunimit mbarëkombëtar në fushën e dijes dhe të shkencës.

Para nxënësve e nxënëseve garues në këtë garë, kryeministri tha se njohuritë në matematikë që fitohen gjatë shkollimit do të jenë një aset i rëndësishëm jetësor që do t'u hapin rrugë për studime dhe zhvillim profesional, pavarësisht prej fushës dhe profesionit që do ta zgjedhin.

Kryeministri Kurti theksoi se në arsim, si edhe në fushat e tjera të qeverisjes, një nga parimet kryesore në të cilat mbështetet qeveria është ai i gjithpërfshirjes. "Në programin tonë qeverisës jemi zotuar që ta avancojmë barazinë në çdo aspekt", potencoi ai.

E ardhmja fatlume e Ballkanit është çmontimi e jo organizimi i tij

"Ballkani i hapur" mund t'i shërbejë çështjes serbe, por jo edhe çështjes shqiptare. Ndërkaq, po ta pranonte Serbia Kosovën si shtet, do të mund të akomodohej disi edhe çështja shqiptare brenda asaj iniciative

Shkruan: Milazim KRASNIQI

Ta organizosh me ndonjë sukses Ballkanin e sotëm, duke i vënë emra të ndryshëm, (Pakti i Stabilitetit, 1999; Procesi i Berlinit, 2014; Minishengeni Ballkanik, 2019; përkatësisht, Ballkani i Hapur, mund të kualifikohet pjesërisht në këtë kuadër edhe Marrëveshja e Uashingtonit, 2020) gjithnjë pa e njohur historinë e tij, mund të duket punë argëtuese, por në të vërtetë është mision i pamundur. Pagëzimet e organizimeve edhe shpallen, festat për to bëhen me pompozitete, por kur të fillojnë të zbatohen konkretisht projektet, ato nisin e deformohen, kalbëzohen, kompromentohen dhe shkatërrohen. Pse?

Ballkani si viktimë e ideologjive ekspansioniste dhe praktikave të kolonializmit

Shtetet e Ballkanit janë shtete kliente (në faza të ndryshme në raste të ndryshme edhe shtete kukulla), që në krye të herës nuk janë formuar si shtet-kombe, po janë të vizatuara për interesat egoiste e militariste të Fuqive të Mëdha. Rolin si shtete kukulla a kliente nuk ua kanë suspenduar as kur ndonjë fuqi ka rënë dhe është zëvendësuar nga ndonjë tjetër. Patroni është zëvendësuar, por varësia ka mbetur. Fjala vjen, shtetet, si Mali i Zi, Bullgaria e Serbia, janë formuar për t'u shërbyer interesave ruse në Ballkan. (Bllokimi i hapësirës ajrore për ministrin rus Llaurov nga Bullgaria e nga Mali i Zi në qershor 2022 paraqet një moment kur këto shtete kalojnë në sferën atlantike, si shtete partnere të SHBA-së) Greqia është formuar si projekt britanik e rus, për ta përdorë si pykë për çmontimin e shtetit osman në Mesdhe, me Qipron si trofe britanik. Shqipëria është formuar si projekt austriak, për të mos lënë shtetet satelite të Rusisë të dilnin më Detin Adriatik. Më vonë, në vitet e nëntëdhjeta të shekullit XX, Maqedonia e Veriut dhe Kosova janë bërë shtete si projekte amerikano-atlantike. Përderisa Kroacia e Sllovenia janë projekte gjermano-atlantike, Bosnja e Hercegovina dejtoniane duket si projekt ruso-amerikan. (Ka edhe variacione, por këtu po ndiqet "atësia" në vijat më të trasha.) Mbetet fakti që asnjëri nga shtetet e sotme ballkanike nuk është formuar pa sponsorizim, pa mbikëqyrje. Ky nuk është mallkim nga arsenali i mitologjive antike pellazge, helene a ilire. Ky realitet është si pasojë e ideologjive ekspansioniste, e praktikave të kolonializmit.

Trashëgimia postosmane si problem i pazgjidhshëm i Ballkanit të sotëm

Meqë këto shtete janë formuar nga sponsorizimi i Fuqive të Mëdha dhe disa prej tyre në mënyrë krejtësisht të panatyrshme (Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut, Kosova), ato vazhdojnë të jenë nën presionin e Fuqive të Mëdha, të cilat kërkojnë që në ato shtete dhe në rajon t'i realizojnë interesat e veta strategjike. Në kondita të atilla, shtetet e sotme të të ashtuquajturit Ballkani Perëndimor, edhe po të duan të arrijnë pajtim, paqe e bashkëpunim miqësor, e kanë të pamundur, sepse nxiten për konflikte nga Fuqitë e Mëdha. Fuqive të Mëdha u konvenojnë konfliktet ndërmjet shteteve të sotme ballkanike, për ta arsyetuar prezencën dhe ndërhyrjen që bëjnë vazhdimisht. Pra, edhe kur shtetet e mëdha dhe organizatat ku ato militojnë bëhen organizatore të projekteve për Ballkanin, brenda atyre projekteve vazhdojnë rivalitetet e tyre për ndikim e protagonizëm, gjë që i dëmton ato projekte. Fjala vjen, iniciativa "Pakti i Stabilitetit" i 30 korrikut 1999 në Sarajevë, i cili në përfundim të luftërave të përgjakshme në ish federatën jugosllave u lancua me pompë e triumfalizëm, pas disa rezultateve në sferën humanitare, shkoi drejt rrëgjimit dhe kalbëzimit. Bashkimi Europian nuk e gjeti formulën që t'i sheshonte kundërthëniet brenda vetes, t'i neutralizonte ndikimet nga jashtë e të sillte prosperitet e drejtësi brenda vetë Ballkanit. Pra, edhe në atë rast, si në çdo rast tjetër të mëvomshëm, historia e panatyrshme dhe e vështirë e shteteve të Ballkanit Perëndimor, e pamundëson zbatimin e suksesshëm të projekteve të përbashkëta, sepse shtetet sponsore ose organizatat ku ato militojnë, nuk lënë të fashiten konfliktet.

Në të vërtetë, edhe vetë emri i rajonit bart në vete një kuptim të thellë për konfliktin, ngatërresën, klientelizmin, vasalitetin. Sipas studiuesit amerikan Mark Mazover, emri Ballkan është i vonë si emërtim për tërë gadishullin, sepse në fillim ai ishte emërtim vetëm për një vargmali. Hapësirat e sotme ballkanike një kohë të gjatë emërtoheshin si "Rumeli" dhe "Turqia Europiane", së paku deri në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Pikërisht diskontinuiteti me shtetin osman solli ndarje, konflikte, gjenocide, ashtu që tash historia postosmane nuk mund të mbahet si themeli mbi të cilin mund të kërkohet ndonjë shtresë e përbashkët e identitetit ballkanik dhe as e interesave të përbashkëta në procesin e integrimeve europiane. Periudha osmane po, por ajo injorohet tërësisht. Thënë thjesht, historia postosmane e rajonit e ka ngarkuar me konotacione negative edhe vetë emrin Ballkan dhe, si e tillë, minon gjithçka. Pra, të vetmen shtresë disi të përbashkët këto shtete e këto kombe e kanë pasur brenda shtetit osman, por atë shtresë e kanë shkatërruar qëllimisht, duke mbetur pa një trashëgimi, e cila sot do të mund t'u ndihmonte shumë. Se a mund të ringjallet ajo shtresë e një përbashkësie kulturore, ekonomike e politike, kjo është pyetje e cila nuk mund të marrë përgjigje, në mungesë të vullnetit, që të kërkohet ndihmesë edhe nga ajo trashëgimi e përbashkët brenda shtetit osman. Në rrethanat kur fuqitë e sotme të mëdha dhe organizatat e tyre politike, ekonomike e ushtarake nuk i lënë këto shtete të aftësohen për politika sovraniste, nuk ka gjasa për një reflektim për vlerat e asaj trashëgimie dhe përdorimin e saj për realitetet e reja të bashkëpunimit e jetës në paqe.

"Ballkani i Hapur" si kornizë për akomodimin e çështjes nacionale serbe

Atëherë si i bëhet, në rrethanat e klientelizmit, vasalitetit dhe të mungesës së kujtesës? Pikërisht iniciativa "Minishengeni ballkanik" a "Ballkani i Hapur" është ilustrim i një përpjekjeje të dëshpëruar për dy gjëra që kanë të bëjnë me këto pyetje. E para, si të dilet disi nga tutela e Fuqive të Mëdha dhe, e dyta, si të harrohet krejtësisht e kaluara që ka ndodhë në periudhën postmosmane, veçmas ndërmjet serbëve e shqiptarëve? Në këtë sfond, "Ballkani i Hapur" është një reagim i dëshpëruar ndaj dyerve të mbyllura të Bashkimit Europian për shtetet e Ballkanit Perëndimor, i ngjizur me njëfarë ndërmendjeje të periudhës osmane, kur popujt ballkanikë kanë pasur periudha të gjata mirëkuptimi e jetese në paqe. Por, është vetëm njëndërmendje halucinante, në luftë me realitetin, pa koherencë, pa mbështetje në logjikën e fakteve. Mungesa e koherencës ndërmjet →

emërtimeve "Minishengeni ballkanik" dhe "Ballkani i Hapur" paraqet problem interesant, që e bën të jetë, si u tha, një ndërmendje halucinante. Kështu, përderisa emërtimi "Minishengeni ballkanik" e mbante një lidhje më të qartë me idenë e integrimit (pra, të bëhej lëvizja e lirë në Ballkan me modelin e Shengenit), në emërtimin që e zëvendësoi "Ballkani i Hapur" ndihet një distancim nga ideja fillestare e imitimit të Bashkimit Europian për lëvizjen e lirë. Është një tentativë fëmijërore për ta ribërë një formacion të kundërvënë ndaj Bashkimit Europian. Por, jo mbi trashëgiminë osmane. Mbi asnjë trashëgimi dhe mbi asnjë logjikë gjeopolitike e gjeokulturore. Bile, në emërtimin e ri ka afri semantike më shumë me idenë e hershme serbomadhe e pansllaviste "Ballkani ballkansave", e cila u shërbente interesave ruse dhe shteteve kliente të Rusisë në Ballkan, Serbisënë rend të parë. Në fakt, semantikisht ka një kundërthënie edhe në vetë sintagmën "Ballkani i Hapur": ai është i mbyllur nga jashtë (nga Bashkimi Europian), ndërsa po synon ta realizojë hapjen brenda, pa pasur fuqinë e duhur dhe as vullnetin e duhur për t'i pranuar realitetet brenda vetes. Thënë thjesht, derisa emërtimi "Minishegeni ballkanik" aspironte imitimin e Bashkimit Europian, emërtimi "Ballkani i Hapur" është refuzim ndaj integrimit europian, në favor të integrimit brendaballkanik, i cili është i pamundur, në rrethanat kur nuk pranohet realiteti – ekzistimi i një shteti si Republika e Kosovës. Atëherë shtrohet pyetja se çka po synohet të arrihet me këtë "hapje nga brenda"? Ndonëse motivet e vërteta nuk janë shpallur, ato mund të deshifrohen duke njohur historinë e decenieve të fundit. E para, me iniciativën "Ballkani i Hapur" po synohet që disi të akomodohen çështja serbe dhe çështja shqiptare, të cilat nuk i arritën objektivat e tyre as pas rënies së Murit të Berlinit dhe pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë. Në fakt, kjo ka të bëjë në rend të parë me çështjen serbe. Serbia tentoi ta realizonte Serbinë e Madhe me tri luftëra gjenocidale (kundër Kroacisë, kundër Bosnjës dhe kundër Kosovës.) Për më tepër, në vitin 2006 u shkëput me anë të një referendumi edhe Mali i Zi nga ajo që quhej "Jugosllavia e Zhablakut". Në këtë mënyrë, Serbia ishte humbësja e madhe nga shpërbërja e ish Jugosllavisë. Vajtimet për dështimin e çështjes nacionale serbe vazhdojnë edhe sot me të njëjtën egërsi propagandistike në Serbi, veçmas kundër Kosovës dhe kundër Bosnjës, por pa shpresë se mund të rikthehet ajo që është humbur në luftë. Si element i përpjekjeve për t'i kompensuar humbjet e rënda është shpikur korniza ballkanike, në të cilën do të mund të akomodoheshin disi të gjithë serbët brenda një kornize ballkanike, pasi nuk arritën të akomodesheshin brenda një shteti kombëtar serb, sipas parullës "Të gjithë serbët në një shtet". Tash është ideja "Të gjithë serbët në Ballkanin e Hapur". E lidhur me sloganin e dikurshëm serbomadh e pansllavist "Ballkani ballkanasve", kjo iniciativë u duket serbëve si melhem për varrë në kujtesën e tyre të rënduar nga traumat e disfatave.

Ndërkaq, në rastin e shqiptarëve, ndonëse ky element mund të ishte i kalkuluar, ai nuk ka qenë motiv i qeverisë shqiptare të Tiranës. Vetë fakti që nuk është harmonizuar qëndrimi me Prishtinën, dëshmon se veprimi i Tiranës është i njëanshëm e nuk e ka preokupim parësor akomodimin e çështjes shqiptare. Në këtë kontekst, mosnjohja e Kosovës si shtet i pavarur nga Serbia e bën të pamundur çfarëdo akomodimi të çështjes shqiptare, me Kosovën si shtet. Prandaj, "Ballkani i Hapur" mund t'i shërbejë çështjes serbe, por jo edhe çështjes shqiptare. Ndërkaq, po ta pranonte Serbia Kosovën si shtet, do të mund të akomodohej disi edhe çështja shqiptare brenda asaj iniciative. Kjo duhet të jetë kërkesa e vazhdueshme: pranimi i Kosovës si shtet i pavarur nga Serbia në pako me anëtarësimin në "Ballkanin e Hapur".

Si të shmanget historia postosmane e Ballkanit nga procesi i integrimit europian

Aktorët ndërkombëtarë kanë pasur e kanë kalkulime të tjera, madje edhe kur deklarojnë përkrahje. Fjala vjen, Rusia nuk e ka preokupim realizimin e çështjes nacionale serbe, por shfrytëzimin e saj si pretekst për ta rritur ndikimin rus në rajon. Kjo është arsyeja pse Llavrovi deklaroi: "E qartë që ata që i tërheqin penjtë në Bruksel këtë nuk e kanë dashur, nuk kanë dashur që ne të shprehim përkrahjen Beogradit, ndër të tjera edhe për projektin Ballkani i Hapur. Tash të gjithëve u është e njohur se Brukseli, NATO dhe Bashkimi Europian duan ta shndërrojnë Ballkanin më një projekt të vetin, të quajtur Ballkani i Mbyllur". Llavrovi e ka ndier se agresioni i Rusisë në Ukrainë po e nxjerrë Rusinë nga loja e madhe e influencave destabilizuese në Ballkanin Perëndimor, prandaj e akuzon me dëshpërim të madh Perëndimin se po e shndërron Ballkanin në një projekt të vetin. Në këto rrethana, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO tashmë synojnë ta marrin nën kontroll edhe iniciativën "Ballkani i Hapur", që ta afrojnë disi Serbinë me orbitën e NATO-s. Deklaratat e Eskobarit, qëndrimi i Kristofer Hillit në takimin e Ohrit, prezenca prej mbikëqyrësi e Aleks Sorosit në takime, janë shenja të kësaj përpjekje amerikane. Ndërkaq Bashkimi Europian, përkatësisht Gjermania, po përpiqet ta neutralizojë "Ballkanin e Hapur", me rikthimin te "Procesi i Berlinit", edhe pse "Ballkani i Hapur" ka filluar të kalojë nga ndikimi rus në ndikimin amerikan.

Konkludimi im është si vijon: përderisa Fuqitë e Mëdha synojnë t'i ruajnë pozitat e tyre si sponsorë, si kontrollorë, si nxitës të konfikteve, si "gazdallarë", nuk ka mundësi të funksionojnë iniciativa puro-rajonale. Thjesht, nuk i lënë të funksionojnë, sepse i vënë në shërbim të interesave të veta. Serbia është rasti më eklatant në këtë mes: ajo është shndërruar në shtet vasal të Rusisë, një Serbi tipike putiniane. Vuçiqi ka deklaruar se asnjë vendim nuk e merr pa u konsultuar me Putinin! Nga ajo pozitë e vasalit të Putinit, ai me siguri edhe atë iniciativën e Novi Sadit, fillimisht e ka diskutuar dhe akorduar me Putinin. (Sa e si do ta largojnë Vuçiqin e Serbinë nga Putini ngjarjet në Ukrainë, kjo ende nuk dihet.)

E dyta, pa një reflektim të thellë të kombeve ballkanike, veçmas të serbëve që kanë bërë krime gjenocidale në Kosovë e në Bosnjë, nuk ka hapësirë për pajtim e bashkëpunim brenda një kornize vetëm rajonale. Për ndryshimin e kësaj gjendjeje, parakusht është pranimi i Kosovës si shtet i pavarur nga Serbia. Por, Serbia nuk e ka në plan njohjen e Kosovës. Në betimin si president i Serbisë, Vuçiqi e ka përsëritur qëndrimin e tij të prerë se Kosovën e sheh brenda Serbisë: "Betohem se gjithë energjinë time do t'ia kushtoj ruajtjes së sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Serbisë, duke përfshirë Kosovën dhe Metohinë si pjesë përbërëse të saj…" (Danas, 31 maj 2022.) Si mund të jetë Kosova e barabartë në iniciativën "Ballkani i Hapur" kur Serbia e konsideron territor të shtetit serb?

Duke e pasur parasysh këtë gjendje në Ballkan, Bashkimi Europian duhet të gjejë mënyra e ta shmangë historinë postosmane të Ballkanit nga procesi i integrimit dhe anëtarësimit. Njohja e Kosovës nga të gjitha shtetet e Bashkimit Europian mbetet parakusht për çfarëdo suksesi. Pra, më së miri është që Ballkani të çmontohet përfundimisht dhe të integrohet i tëri në Bashkimin Europian, pa emrin e vet konfiktuoz, pa ngarkesën e së kaluarës së hidhur. Realisht, këtë detyrë historia ia ka ngarkuar Bashkimit Europian. Por, kjo detyrë ende është larg që të kryhet me sukses prej tij. Deri atëherë do të eksperimentohet me organizime të pasuksesshme.

P. S. *Ata që e kanë ndonjë kureshtje për Ballkanin, do të duhej që t'i lexonin/studionin edhe këta autorë: Mark Mazover: Ballkani dhe Selaniku qytet i fantazmave; Maria Todorova: Ballkani imagjinar; Justin McCarthy: Vdekje dhe dëbim; Peter Sugar, Europa Juglindore nën sundimin osman (1354-1804); Peter Bartl: Muslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912); Branimir Anzulloviq: Serbia hyjnore; Ivan Qolloviq: Vdekja në Fushën e Kosovës; Robert Mantrani: Perandoria Osmane, Historia e perandorisë osmane; Millan Suflaj, Serbët dhe shqiptarët; Nyraj Bozbora, Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane.*

Ish-prokurorja që sinjalizoi korrupsionin në EULEX fiton rastin gjyqësor me qeverinë britanike

Prishtinë, 3 korrik (ER) - Maria Bamieh, një ish-prokurore e shkarkuar pasi kishte sinjalizuar për korrupsion në misionin më të madh të jashtëm të BE-së në Kosovë, EULEX, do të paguhet më shumë se 400 mijë paund nga Britania e Madhe si dëmshpërblim, raporton The Guardian.

Maria Bamieh ka pretenduar për tetë vitet e fundit se Zyra e Jashtme për Zhvillim (FCDO), një department i qeverisë britanike dështoi të ofrojë mbështetje për të pasi ajo u përpoq të ekspozonte bashkëpunimin e mundshëm midis zyrtarëve të BE-së dhe kriminelëve të dyshuar në Kosovë.

Në vend të kësaj, tha ajo, zyrtarët qeveritarë i thanë asaj që të injoronte provat e dukshme të marrëveshjes së fshehtë në misionin e BE-së për sundimin e ligjit, të quajtur EULEX.

Rasti i saj pritej të shqyrtohej në gjykatë në maj dhe qershor të këtij viti, por palët u ranë dakord për një dëmshpërblim prej rreth 423,000 paund britanikë pak para seancës së pare.

FCDO tha se vazhdon të mohonte me forcë pretendimet e Bamieh.

Maria Bamieh kishte akuzuar misionin e EULEX-it për largim të padrejtë nga puna pasi bëri akuza për korrupsion kundër prokurorëve dhe gjykatëseve ndërkombëtarë që shërbenin në Kosovë.

Bamieh pretendonte se kishte qenë në njohuri se si një gjyqtar i EULEX-it kishte pranuar rreth 300 mijë euro në kompensim për të liruar nga akuzat një ish-zyrtar të lartë të Ministrisë së Shëndetësisë.

Pas largimit nga ky mision, Bamieh ka vazhduar betejën e saj ligjore kundër EULEX-it në Britani të Madhe.

EULEX është misioni më i madh i dërguar jashtë vendit nga Bashkimi Evropian.

Qëllimi i EULEX-it është t'i mbështesë institucionet përkatëse të sundimit të ligjit në Kosovë.

Që nga ardhja në Kosovë në vitin 2008 ky mision i ka kushtuar BE-së qindra miliona euro.

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Selimi: Rast që të paraqesim vlerat tona para shteteve mosnjohëse

PRISHTINË, 3 KORRIK - Nga 11 deri më 17 korrik Kosova do të jetë nikoqire e Kupës së Botës në hendboll për universitete. Për gjashtë ditë, në Prishtinë do të qëndrojnë studentë nga rreth 20 vende të botës që do të kërkojnë titullin e më të mirit në këtë kampionat. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, Ministria e Kulturës dhe Sportit, Federata e Hendbollit dhe Komuna e Prishtinës, kanë bashkuar forcat për organizimin sa më të mirë të kësaj ngjarje të madhe me përmasa botërore.

Musa Selimi, dekan në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, duke folur për "KosovaPress", tregon rëndësinë e kësaj ngjarje që mbahet në Prishtinë, si dhe punën që u bë për ta fituar organizimin e këtij kampionati. "Po kemi pasur rivalitet, kanë qenë disa shtete të cilat kanë aplikuar në konkursin që ka qenë në kuadër të FISU-së, që është mbajtur në Lozanë sepse selia e FISU-së, është në Lozanë, dhe në këtë drejtim ne e kemi shkuar me një projekt shumë të detajizuar, të përgatitur enkas për këtë ngjarje dhe kemi prezantuar Kosovën, Prishtinën si kryeqytet, kemi prezantuar palestrat tona, konviktet dhe ka qenë interesant për komisionin prej pesë anëtarëve, paneli i të cilëve na ka intervistuar dhe ka bërë pyetje vazhdimisht se donin të dinin të gjitha informacionet dhe mos të mbeten mangu sa i përket informatave. Kjo ka qenë tre muaj para se të merret vendimi, në vitin 2019 dhe në pjesën e dytë të dhjetorit 2019, ne e kemi marrë vendimin nga sekretari gjeneral që Kosova do të jetë nikoqire e kësaj ngjarje", ka thënë Selimi. "Ne kemi shtete pjesëmarrëse nga tri kontinente, në fakt ka qenë edhe një ekip nga Amerika Jugore, Brazili, por ende nuk e dimë saktë për shkak të rrugës së gjatë. Ata fillimisht janë regjistruar por nuk e kanë konfirmuar ende se a do të jenë edhe ata mysafirë. Nga Azia kemi Korenë e Jugut, universitetin e ekipit të Seulit…pastaj vijnë nga Evropa, Republika e Çekisë, Portugalia, prapë nga Azia e kemi Turqinë, nga Afrika e kemi Egjiptin, Uganda, e cila po ashtu ende nuk është definitive për shkak të organizimit dhe ndoshta kanë problem edhe me marrjen e vizave…kemi ekipe nga Spanja, Egjipti, shtete që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës dhe për ne është shumë me rëndësi kjo edhe në aspektin politik dhe diplomacisë sportive që ne t'i presim në mënyrën më të mirë… Po ashtu, nga regjioni kemi ekipe nga Kroacia, Shqipëria nga Mali i Zi", ka shtuar Selimi. Sa i përket infrastrukturës sportive që nevojitet për zhvillimin e ndeshjeve, Selimi ka thënë se janë bërë të gjitha përgatitjet dhe se Pallati i Rinisë dhe Salla "1 Tetori", janë në kushte optimale për zhvillimin e të gjitha përballjeve. "Ne presim dy konkurrencat. Konkurrencën e meshkujve që do të jenë 10-12 ekipe dhe konkurrencën e femrave që do të 8-10 ekipe. Ne kemi dy palestra jashtëzakonisht mirë të përgatitura sa i përket ndeshjeve të cilat do të zhvillohen dhe po ashtu kemi një bashkëpunim të ngushtë me Federatën e Hendbollit të cilët me marrëveshjen që e kemi arritur, do të përkujdesen komplet për pjesën teknike, përgatitjen e ekipeve, caktimin e selektorëve, seleksionimin e lojtarëve që do ta bartin emrin e Universitetit të Prishtinës 'Hasan Prishtina' dhe në këtë drejtim mendoj që jemi jashtëzakonisht mirë të përgatitur", ka deklaruar ai. E sa i përket aspektit sportiv dhe rezultateve që Kosova i synon në këtë kampionat, Selimi bëri me dije se kjo është më pak e rëndësishme krahasuar me mbarëvajtjen e organizimit sepse kjo do t'i jepte një imazh shumë të mirë Kosovës në të gjithë botën.

SHKURT

Arbër Azemi eliminohet nga lojërat mesdhetare

Arbër Azemi është eliminuar nga Lojërat Mesdhetare që po zhvillohen në Oran të Algjerisë. Kosovari që ka garuar në taekwondo është mposhtur në ndeshjen e parë nga greku Kostantinos Chamalidis. Chamalidis ishte më i mirë se Azemi gjatë tërë ndeshjes, falë edhe përvojës që kishte, duke e ditur se ishte kampion i këtyre lojërave në kategorinë e tij, në vitin 2018. Sot (e hënë) garon, taekwondisti tjetër, Arbër Bajra, në kategorinë -80 kg.

Zenelaj vazhdon me Prizrenin

KB Ponte Prizreni ka njoftuar se qendra nga Suhareka, Urim Zenelaj ka vazhduar kontratën edhe për një tjetër sezon. Në njoftimin e klubit thuhet se pavarësisht ofertave të shumta, Zenelaj vendosi t'i mbetet besnik Prizrenit. "Lojtari më besnik i skuadrës Urim Zenelaj qëndron tek skuadra jonë. Pa dyshim qendra numër një në Kosovë 'king of paint' tani i bënë 5 vite në skuadër përkundër shumë ofertave tjera ai qëndron besnik skuadrës së zemrës. Urim Zenelaj pritet të jetë arma më e fort e ekipit, pasi që pas përfundimit të sezonit është nënshtruar dy intervenimeve mjekësore", thuhet në njoftimin e KB Ponte Prizreni.

Urim Statovci përforcon Vushtrrinë

Skuadra e Vushtrrisë e ka zyrtarizuar transferimin më të ri. Bëhet fjalë për sulmuesin Urim Statovci i cili u morë nga Fushë Kosova. Lojtari bëri paraqitje shumë të mira në Ligën e Parë viteve të fundit, e për rrjedhojë ka ngjallur interesimin e shumë skuadrave. Më herët i njëjti luante për Trepçën '89, Arbërinë e Ulpianën.

Useini nënshkruan kontratë dyvjeçare me Prishtinën

Prishtina ka vazhduar ta përforcojë ekipin për edicionin e ri në Superligën e Kosovës. Transferimi i radhës i gjigantit kosovar është mesfushori defensivë Muhamed Useini i cili vije në Prishtinë pas aventurës tri vjeçare me Gjilanin. 33-vjeçari ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me kampionin e shumëfishtë të Kosovës. Shkëndija e Tetovës, Rabotniçki, Renova dhe Flamurtari i Vlorës janë skuadrat me të cilat është paraqitur në karrierën e tij. "Për Prishtinën vendova pasi që më bindi projekti i klubit dhe trajneri Ismet Munishi. Lojtarët nuk mendohen dy herë kur ju vjen mundësia të aktivizohen për një klub si Prishtina. Për mua do të thotë nder, kënaqësi dhe privilegj të aktivizohem për një klub të madh si Prishtina. Synimet janë që të komponohemi sa më shpejtë dhe të luajmë një futboll të bukur dhe ndeshje pas ndeshje t'i arrijmë qëllimet tona. Tifozëve ju premtoj se do të japim më shumë se 100 për qind nga vetja që të shfaqim më të mirën tonë dhe besoj se sivjet do ta shikojnë një Prishtinë të fortë", ka thënë Useini për faqen zyrtare të klubit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "DHF Company" Sh.p.k. Pejë , në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Stacionin e karburanteve në Z.K. Llazicë, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 25.07.2022 në ora 10:00, në Restorantin " Tali" , i cili gjendet në afërsi të lokacionit të pikës së karburantit në segmentin rrugor Llozicë - Peje në anën e djathtë të ketij aksi rrugore do të organizohet debat publik nga Kompania "DHF Company" Sh.p.k. Pejë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Stacionin e karburanteve në Z.K. Llazicë, Malishevë edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOm Linku:
https://us04web.zoom.us/j/

71771074718?

pwd=kPxnUe9MGRmNXRLXqozNI

DTQcyld8_.1

Meeting ID: 71771074718

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë " DHF Company" Sh.p.k. Pejë për stacionin e karburanteve në në Z.K. Llazicë, Malishevë

.https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Kemal Ramizagic shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Jasin Vermica shpall te pavlefshme dëftesën e kl. X. Q.K " 11 Marsi " Prizren.

▶ Ermal Begu shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e SHMLM " Xheladin Deda".

▶ Mirlinda Gerguri shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLM " Dr Xheladin Deda".

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULE
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues